

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është të krijojë bazën ligjore për integrimin e politikave dhe për masa efektive që mundësojnë:

- a) plotësimin e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë ndaj Konventës për arritjen e objektivit final të saj, përmes nxitjes së reduktimit të shkarkimeve GES dhe ruajtjes dhe rritjes së përthithësve e rezervuarëve të vendit;
- b) përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar dhe/ose lokal; dhe
- c) evidentimin e arritjeve të vendit në këto drejtime duke përdorur metodologji sipas modeleve të Konventës dhe të BE-së.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2018-2020 detyrimin për përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së në fushën e ndryshimeve klimatike dhe, konkretisht, hartimin e projektvendimit për rregulloren për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES dhe të informacioneve të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar. Ky është vetëm një nga aktet e *acquis* që duhet të miratohen në Shqipëri në periudhën afatshkurtër e afatmesme. Projektligji për ndryshimet klimatike krijon bazën ligjore për këtë projektvendim dhe do të shërbejë si kuadër ligjor mbështetës për shumë akte të tjera nënligjore në fushën e ndryshimeve klimatike, që duhet të miratohen në vijim, për të transpozuar direktiva e rregullore të tjera të BE-së në këtë fushë. Projektligji është parashikuar në planin analitik për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Shqipëria ka ratifikuar Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuar për Ndryshimet Klimatike ku ajo është palë e jo-aneksit I, si dhe Protokollin e Kiotos në kuadër të kësaj konvente. Aktualisht, Shqipëria ndodhet në një situatë

komplekse lidhur me harmonizimin e legjislacionit të BE-së për klimën, pasi duke qenë një vend i jo-aneksit 1 nuk ka detyrim për reduktim, ndërkohë që përpjekjet për t'u integruar në BE e afrojnë më shumë me këtë detyrim.

Hartimi i legjislacionit në këtë fushë është një kërkesë e kohës. Sot ka një thirrje të përgjithëshme në nivel ndërkombëtar për të përgatitur kuadrin ligjor për çështje të klimës por edhe reagim nga një numër shumë i madh vendesh, të jo-aneksit 1, të cilat kanë miratuar dhe po vazhdojnë të miratojnë akte lidhur me ndryshimet klimatike. Një studim i GLOBE (*The Global Legislators Organisation*), i kryer në vitin 2015, tregoi që aktualisht, 99 vende kanë 804 akte ligjore dhe politike të miratuara për klimën. Edhe raportet e fundit të progresit për Shqipërinë theksojnë nevojën për përgatitjen dhe harmonizimin e legjislacionit në fushën e klimës, i cili është në fazat e para të përgatitjes.

Raporti i progresit për vitin 2013 theksonte se zhvillimi dhe përshtatja e një politike dhe një strategjie gjithëpërfshirëse në përputhje me kornizën e politikës së BE-së për 2013 mbi klimën dhe energjinë... Shqipëria duhet të konsiderojë marrjen e angazhimeve për reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, në pajtim me ato të BE-së dhe shteteve anëtare, me qëllim arritjen në vitin 2015 të marrëveshjes së klimës së pas-2020-ës...Nevojiten akoma përpjekje për të nxitur kapacitetin monitorues, raportues dhe verifikues në vend... Ndërgjegjësimi për klimën është i ulët dhe kërkohet fuqizim i mëtijshëm i bashkëpunimit mes të gjithë aktorëve.

Raporti i progresit për vitin 2015 theksonte se harmonizimi me rregulloren e BE-së për një mekanizëm monitorimi dhe raportimi duhet të jetë prioritet. Ngritja e sistemit për monitorimin, verifikimin dhe raportimin për shkarkimin e gazeve serrë nuk ka filluar ende.

Raporti i progresit për vitin 2016 theksonte se në vitin në vijim, vendi duhet në veçanti të përmirësojë kuadrin ligjor dhe politik për mjedisin dhe klimën... dhe të ngrejë një planifikim strategjik sistematik për ndryshimet klimatike dhe të ndjekë zbatimin e Marrëveshjes së Parisit për Klimën... Përpjekje të tjera duhen bërë për harmonizimin e legjislacionit për substancat ozon holluese dhe gazet serrë të florinuara, si dhe të direktivave për tregtinë e shkarkimeve të gazeve serrë dhe ruajtjen gjeologjike të CO₂.

Për sa më lart, meqenëse aktualisht nuk ka një legjislacion specifik që shërben si bazë ligjore për aktet nënligjore mbi ndryshimet klimatike, që kërkohen herë pas here të hartohen nga UNFCCC dhe/apo BE-ja, dhe duke vazhduar në traditën e vendosur tashmë për të pasur nga një ligj kuadër për të gjitha çështjet tematike të mjedisit, me mbështetjen e projektit IBECA, të financuar nga IPA 2013, u përgatit fillimisht ky projektligj kuadër për ndryshimet klimatike. Ai krijon bazën ligjore dhe kuadrin institucional për plotësimin e detyrimeve të vendit ndaj konventës, vendimeve të konferencave të palëve, por edhe për përafrimin me *acquis* për klimën duke filluar me aktet e përmendura në raportin

e progresit për vitet 2013, 2015 dhe 2016.

Paralelisht me hartimin e këtij projektligji po punohet edhe për harmonizimin e rregullores 525/2013/EC së BE-së për ngritjen e një mekanizmi për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve serrë dhe të çështjeve të tjera që lidhen me klimën në nivel kombëtar. Bashkëpunimi ndërinstitucional për zbatimin e detyrimeve të konventës dhe të *acquis* rregullohet me ligj duke përcaktuar përgjegjësi të qarta për çdo institucion. Dhe ngritja e kapaciteteve reale për monitorim, raportim dhe verifikim mund të bëhet vetëm mbi baza ligjore të shëndosha.

Projektligji është hartuar duke përdorur terminologjinë e konventës, të vendimeve të konferencave të palëve dhe të *acquis* për ndryshimet klimatike. Përmbajtja e tij është hartuar duke mbajtur parasysh:

- statusin si vend i jo-aneksit 1 në Konventë, kërkesat e konventës, të vendimeve të Konferencave të Palëve dhe të Protokollit të Kiotos për vendet me këtë status;
- *acquis* për ndryshimet klimatike, situatën aktuale të Republikës së Shqipërisë si një vend kandidat që po punon intensivisht për të filluar negociatat për t'u bërë vend anëtar i BE-së dhe për të përmbushur të gjitha kërkesat e BE-së që janë të nevojshme, të mundura dhe që kanë kuptim në fazën e para pranimit;
- angazhimin e fundit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet INDC-së.

Për sa më lart, nga Direktiva 2003/87/EC që përcakton një skemë për tregtimin e lejeve për shkarkim të gazeve serrë brenda Komunitetit ... dhe amendamentet e saj janë transpozuar vetëm kërkesat lidhur me monitorimin dhe raportimin. Në këtë moment, duke mos qenë ende shtet anëtar i BE-së, Republika e Shqipërisë nuk ka status për të qenë pjesë e kësaj skeme. Për më tepër që, edhe teknikisht, nuk mund të jemi pjesë e kësaj skeme pa ngritur më parë një sistem të shëndoshë, mbështetur në ligj për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të gazeve serrë. Tregtia e shkarkimeve nuk mund të fillojë pa një sistem të tillë efektiv dhe të besueshëm. Pjesëmarrja në skemën e tregtisë së shkarkimeve mund të rregullohet me legjislacion të posaçëm, pasi sistemi i monitorimit, raportimit dhe verifikimit të jetë efektiv dhe Republika e Shqipërisë të jetë bërë vend anëtar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj hartohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji “Për ndryshimet klimatike”, përafron pjesërisht direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 13 tetor 2003 për krijimin e një skeme për tregtinë e e lejeve për shkarkimet e gazeve serrë brenda Komunitetit dhe që amendon direktivën e Këshillit 96/61/EC (CELEX 32003L0087) të amenduar nga:

- Direktiva 2004/101/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 27 tetor 2004 që amendon direktivën 2003/87/EC për krijimin e një skeme për tregtinë e e lejeve për shkarkimet e gazeve serrë brenda komunitetit në zbatim të mekanizmave të projektit të Protokollit të Kiotos (CELEX 32004L0101);
- Direktiva 2008/101/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 19 nëntor 2008 që amendon direktivën 2003/87/EC, duke përfshirë aktivitetet e aviacionit në skemën për tregtinë e e lejeve për shkarkimet e gazeve serrë brenda Komunitetit (CELEX 32008L0101);
- Direktiva 2009/29/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 prill 2009 që amendon direktivën 2003/87/EC, duke përmirësuar dhe zgjeruar skemën për tregtinë e e lejeve për shkarkimet e gazeve serrë brenda komunitetit (CELEX 32009L0029).

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ligji është parashikuar të hyjë në fuqi 6 muaj pas botimit në “Fletoren zyrtare”. Aktet nënligjore që burojnë prej tij duhet të jenë miratuar brenda 4 vitesh, nga data e hyrjes në fuqi. Për çështje të lejes së mjedisit që përfshin gazet serrë, për përgatitjen e sistemit të monitorimit, raportimit dhe verifikimit pas miratimit të akteve nënligjore të përmendura më lart, operatorëve u jepet një periudhë tranzicioni prej 5 vitesh, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pra një vit pasi të jenë miratuar ato akte.

Projektligji është i përbërë nga 6 krerë, 7 seksione, 47 nene dhe 9 anekse.

Kreu I, Dispozita të Përgjithshme.

Në këtë kapitull përcaktohet qëllimi i projektligjit, fusha e zbatimit të tij si dhe përkufizimet dhe parimet themelore.

Kreu II, “Zbutja dhe përshtatja” është ndarë në 7 seksione. Në 4 seksionet e para trajtohen veç e veç shkarkimet e GES-it nga instalimet e palëvizshme, nga sektori i transportit, energjia, ndërtimi dhe përdorimi i disa produkteve. Në seksionin 5 trajtohet përthithja e shkarkimeve nga pyjet dhe bujqësia dhe kapja

dhe depozitimi gjeologjik i shkarkimeve të GES-it. Në seksionin e gjashtë trajtohen strategjitë e zbutjes dhe të adaptimit, kurse në seksionin e shtatë matja, raportimi dhe verifikimi.

Seksioni i parë i kushtohet shkarkimeve të gazeve serrë nga instalimet e palëvizshme. Këtu futet për herë të parë koncepti i lejes së mjedisit që përfshin edhe gazet serrë; informacioni që kërkohet në një aplikim për leje mjedisi, kushtet që duhet të plotësojë një aktivitet/operator lidhur me shkarkimet e gazeve serrë për të marrë një leje mjedisi që i përfshin gazet serrë; kërkesat që i caktohen atij në lejen e mjedisit për këto shkarkime; kërkesat për monitorim, raportim verifikim të këtyre shkarkimeve dhe akreditim të verifikuesve. Këto kërkesa burojnë nga direktiva 2003/87/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 13 tetor 2003 për krijimin e një skeme për tregtinë e lejeve për shkarkimet e gazeve serrë brenda Komunitetit dhe që amendon direktivën e Këshillit 96/61/EC; e amenduar si më lart. Lista e gazeve serrë që mbulohen nga ky projektligj, lista e aktiviteteve dhe gazeve serrë që janë objekt i monitorimit, raportimit dhe verifikimit për qëllime të pjesëmarrjes (potencialisht në të ardhmen) në tregtinë e shkarkimeve jepen në anekset I dhe II. Ky seksion, së bashku me një pjesë të seksionit të dytë hapin bazën ligjore për vendime të Këshillit të Ministrave që harmonizojnë kërkesat me *acquis*¹.

Seksioni i dytë, në nene të veçanta, i referohet shkarkimeve nga sektori i transportit: aviacioni ndërkombëtar, lundrimi ndërkombëtar dhe transporti rrugor. Lista e aktiviteteve të aviacionit ndërkombëtar, që përjashtohen nga kërkesat e këtij seksioni, jepet në aneksin III. Në këtë seksion hapet baza ligjore për disa vendime të Këshillit të Ministrave që harmonizojnë kërkesat me *acquis*.

Seksioni i tretë, në dy nene të veçanta, i kushtohet shkarkimeve nga sektori i energjisë dhe ndërtimit. Këtu nuk përcaktohen kërkesa specifike, por thjesht i bëhet referencë akteve respektive në këtë fushë. Qëllimi është që projektligji të japë një panoramë sa më të plotë të të gjithë faktorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet shkarkimeve të tyre kontribuojnë për ndryshimet klimatike, por nga ana tjetër kanë edhe një potencial të lartë për t'u përshtatur ndaj tyre.

Në seksionin e katërt, në 3 nene të veçanta trajtohen kërkesat për disa produkte sic janë:

- lëndët djegëse dhe burimet e rinovueshme të energjisë, përfshirë biokarburantet, ku krijohet baza ligjore për një vendim të Këshillit të Ministrave;
- substancat ozon holluese, të cilat vetëm përmenden për potencialin e tyre për krijimin e efektit serrë, por lihen të trajtohen me legjislacion të posaçëm;

- gazet e florinuara, ku krijohet baza ligjore për disa vendime të Këshillit të Ministrave që do të sigurojnë harmonizimin me rregulloret e BE-së në këtë fushë.

Në seksionin e pestë, në dy nene të veçanta trajtohen pyjet dhe bujqësia, si një nga përthithësit e gazeve serrë dhe depozitimi gjeologjik i CO₂, ku hapet baza ligjore për një vendim të Këshillit të Ministrave që do të sigurojë harmonizimin me një rregullore dhe *acquis* dhe një vendim të Këshillit të Ministrave që transponon një direktivë.

Në seksionin e gjashtë, në nene të veçanta trajtohen kërkesat që duhet të plotësojë dokumenti “Përcaktimi i Kontributit Kombëtar” (NDC), i cili, në fakt, përcakton objektivin e strategjisë për zbutje, kërkesat që duhet të plotësojë kjo strategji si dhe masat zbutëse të përshtatshme për vendin (NAMAt), si plane veprimi në zbatim të kërkesave specifike të strategjisë së zbutjes. Ky seksion përcakton edhe kërkesat për strategjinë për adaptim dhe planin përkatës të veprimit. Për të dyja strategjitë, referuar në këtë seksion, ndërmerret qasja e integritetit me strategjitë sektoriale dhe strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim. Detajet për secilin dokument jepen në anekset IV, V, VI dhe VII të projektligjit.

Në seksionin e shtatë, në tre nene të veçanta, trajtohet sistemi i matjes, raportimit dhe verifikimit përtej nivelit të operatorit; hapet baza ligjore për harmonizimin me një rregullore të *acquis*; përcaktohet detyrimi për përgatitjen e komunikimeve kombëtare katërvjecare dhe të raporteve azhornuese dyvjeçare të tyre. Edhe për këto, kërkesat e detajuara jepen në anekset VIII dhe IX.

Kreu III: Autoritetet kompetente, në 2 nene të veçanta përcakton kuadrin institucional për zbatimin e kërkesave të këtij ligji dhe koordinimin ndërinstitutional aq të nevojshëm për çështje të tilla, siç është klima dhe detyrimet e ministrive të linjës dhe të pushtetit vendor, jo vetëm për të integruar klimën në politikat e tyre por edhe për t’i zbatuar bashkërisht ato dhe për të bashkëpunuar edhe përtej nivelit kombëtar, në nivel dypalësh, shumëpalësh dhe ndërkombëtar.

Thelbi i këtij kapitulli është përcaktimi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si *focal point* kombëtar për Konventën e Ndryshimeve Klimatike dhe si institucioni përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe menaxhimin e sistemit të monitorimit, raportimit dhe verifikimit, përfshirë procesin e përgatitjes së komunikimit kombëtar dhe raporteve azhornuese dyvjeçare. Agjencia Kombëtare e Mjedisit caktohet si autoriteti kombëtar kompetent për ngritjen dhe mbajtjen e sistemit kombëtar të inventarit të gazeve serrë, si pjesë e sistemit të informacionit mjedisor. Ministrinë e linjës, institucionet në varësi të tyre, pushteti vendor, INSTAT-i dhe Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit kanë detyrime raportuese dhe për bashkëpunim me Ministrinë dhe

Agjencinë Kombëtare të Mjedisit deri në përfundimin dhe miratimin e dokumenteve që kërkohen nga ky projektligj.

KREU IV: Ndërtimi i kapaciteteve, edukimi, trajnimi, ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e publikut trajton këto çështje në katër nene të veçanta, duke përcaktuar edhe detyrimin e institucioneve përgjegjëse.

KREU V: Investimet dhe financimet e gjelbërta trajtohet në katër nene të veçanta. Këtu, nga ministritë e linjës kërkohet që me politikat e tyre të nxisin investime miqësore ndaj mjedisit dhe klimës, të përfshijnë sektorin privat në përpjekjet për të arritur objektivat e vendosur në politikën kombëtare për klimën, transferimin e teknologjive me pak karbon në fusha të caktuara, të përfitojnë nga fondet kombëtare, të nxisin pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe të përfitojnë financime nga fondet ndërkombëtare për klimën.

KREU VI: Dispozita kalimtare dhe të fundit përcakton detyrimet e ministrive të linjës për menaxhimin e informacionit të kërkuar nga ky ligj, të operatorëve të instalimeve, të operatorëve të aviacionit dhe të operatorëve të lundrimit ndërkombëtar në zbatim të seksioneve dhe të neneve përkatëse të këtij projektligj; detyrimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për raportim mbi zbatimin e këtij projektligji; aktet nënligjore që duhen përgatitur në zbatim të tij; aktet që vazhdojnë të kenë fuqi ligjore pas miratimit të tij dhe shfuqizimet. Një nen i veçantë i kushtohet kundërvajtjeve, të cilat kanë të bëjnë me mosrespektimin e detyrimeve raportuese të operatorëve të kategorive të ndryshme sipas kërkesave të këtij ligji, në analogji dhe sintoni të plotë me kërkesat e ligjit “Për lejet e mjedisit”

Teksti i projektligjit shoqërohet nga 9 anekse, si pjesë përbërës të tij.

Aneksi I: Gazet me efekt serrë.

Aneksi II: Kategoritë e aktiviteteve dhe GES që i nënshtrohen kërkesave të këtij ligji.

Aneksi III: Lista e aktiviteteve të aviacionit që përjashtohen nga ky ligj.

ANEKSI IV: Lista joshterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin “Përcaktimi i kontributit kombëtar të pikësnyuar (NDC)”.

ANEKSI V: Lista joshterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin “LCDS”.

ANEKSI VI: Lista joshterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin “NAMA”.

ANEKSI VII: Lista joshterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin “Strategjia dhe Plani Kombëtar për Përshtatje (NAP)”.

ANEKSI VIII: Lista joshterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin “Komunikimi Kombëtar”.

ANEKSI IX: Lista joshterruese e çështjeve që duhen trajtuar në dokumentin “BUR”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit;
- INSTAT-i;
- NJQV-të.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit) me asistencën e projektit IBECA, të financuar nga BE-ja. Projekti është bashkërenduar edhe me ministrinë e linjës që kanë detyrime të drejtpërdrejta në nene të caktuara të këtij ligji, pikërisht për ato nene, dhe është prezantuar dhe diskutuar 2 herë me ministrinë e linjës dhe grupin ndërmënytor të punës për ndryshimet klimatike, përpara se të kryhej procesi i konsultimit zyrtar të tij.

Lidhur me procesin e konsultimit publik të këtij projektligji, sqarojmë se:

Procesi i konsultimit për përgatitjen e projektligjit është kryer nëpërmjet një sërë takimesh për mbledhjen e informacionit dhe njohjen me metodologjinë e punës dhe *workshop*-et për prezantimin e versioneve të ndryshme të projektligjit, të përgatitura me konsulentin e projektit të Bashkimit Evropian, IBECA. Pas çdo *workshop*-i, ministrinë kryesore të linjës ishin të ftuara të dërgonin komentet/kontributet e tyre me shkrim, të cilat janë marrë parasysh gjatë hartimit të draftit final.

Më 28 shkurt 2017, projekti IBECA, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, organizoi prezantimin dhe diskutimin e projektligjit “Për ndryshimet klimatike” në hotel Tirana. Në takim morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Delegacioni i Bashkimit Evropian në

Shqipëri, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bashkia e Tiranës, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, ish-Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, OJQ dhe kompanitë private.

Dokumenti i NDC-së përcakton kontributin kombëtar për reduktimin e gazeve me efekt serrë, përkundrejt arritjes së objektivit global të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike për mbajtjen e temperaturave në 2°C, duke kufizuar rrezikun e ardhshëm dhe kostot e përshtatjes ndaj ndryshimeve të klimës.

Ky projektligj është konsultuar me grupin ndërinstitutional të punës dhe grupet e interesit dhe janë pasqyruar të gjitha komentet në draftin përfundimtar.

Ky ligj do të hyjë në fuqi 6 muaj pas miratimit të tij, ndërsa kostot financiare për buxhetin e shtetit të përlogaritura bazuar mbi dokumentet e PBA 2020-2022 dhe angazhimet e donatorëve fillojnë menjëherë.

Projektligji “Për ndryshimet klimatike”, parashikon hartimin e dokumentit strategjik dhe planeve kombëtare për ndryshimet klimatike.

Dokumenti Strategjik për Ndryshimet Klimatike krijon kuadrin e përgjithshëm kombëtar për veprim ndaj ndryshimeve klimatike dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit.

Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) janë pjesë përbërëse e Dokumentit Strategjik.

Kostot e implementimit të këtij Dokumenti Strategjik, të përcaktuara në planet e veprimit, të cilat përmbledhin masat kombëtare për implementimin e Dokumentit Strategjik, përbëjnë edhe kostot e implementimit të vetë ligjit.

Sipas analizës së masave për secilin prej sektorëve të përfshirë, kostot e implementimit të këtij dokumenti, janë si më poshtë:

Në 000 lekë

	Buxheti i Shtetit	BE	Donatorë të tjerë	Hendeku financiar	Total
Energjia	23 422 408	-	6 551 819	6 906 638	29 974 227
Transporti	38 354 551	262 320	6 811 289	5 270 346	45 428 160
Bujqesia	9 663 350	-	1 064 214	-	10 727 564
Toka+Pyjet	1 471 226	-	-	4 480	1 471 226
Ndersektori ale	-	-	15 000	15 000	15 000
Total	72 911 535	262 320	14 442 322	12 196 464	87 616 177

Sipas viteve:

Sektori	2019	2020	2021	Total
Energjia	405 200	2 578 362	7 445 752	10 429 314
Transporti	4 490 150	16 309 586	15 320 984	36 120 720
Bujqesia	2 355 607	3 065 704	2 591 000	8 012 311
Toka+Pyjet	325 386	403 640	413 600	1 142 626
Ndersektoriale	-	15 000	-	15 000
Total	7 576 343	22 357 292	25 771 336	55 719 971

Sektori	2022	2023	2024	Total
Energjia	12 452 204	311 619	666 960	13 430 783
Transporti	2 637 396	808 538	5 643 316	9 089 250
Bujqesia	2 715 253	-	-	2 715 253
Toka+Pyjet	38 600	250 000	40 000	328 600
Ndersektoriale	-	-	-	-
Total	17 843 453	1 370 157	6 350 276	25 563 886

	2025	2026	2027	Total
Energjia	910 130	5 204 000	-	6 114 130
Transporti	217 070	1 120	-	218 190
Bujqesia	-	-	-	-
Toka+Pyjet	-	-	-	-
Ndersektoriale	-	-	-	-
Total				

	1 127 200	5 205 120	-	6 332 320
--	-----------	-----------	---	-----------

Hendeku financiar i përlllogaritur është rreth 12% e kostos totale të implementimit të ligjit.

	Buxheti + Donatorë	Hendeku
Total	87 616 177	12 196 464

Të gjitha përlllogaritjet janë në mijë lekë

Kostot e implementimit të ligjit deri në vitin 2022 janë mbështetur në dokumentet e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 të institucioneve përgjegjëse. Hendeku financiar përbën efektivisht kostot e implementimit përtej 2022, ç'ka do të thotë që institucionet përgjegjëse duhet të angazhohen të përcaktojnë në dokumentet e PBA-së të viteve në vijim, masa konkrete dhe buxhete të mjaftueshme për implementimin e tyre. Në rast se tavanet buxhetore nuk arrijnë të adresojnë hendekun financiar të përlllogaritur, atëherë do të duhet të angazhohen të gjithë aktorët për të siguruar fonde nëpërmjet instrumenteve të tjera (ndryshime në paketat fiskale, subvencione, etj) apo donatorëve.

Ndër të tjera, në nenin 5, pika 7, projektligji parashikon që:

Dokumenti Strategjik, Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) rishikohen çdo 4 vjet.

Për rrjedhojë, kostot e implementimit të ligjit, nëpërmjet Dokumentit Strategjik dhe planeve të veprimit përkatëse, do të rishikohen bazuar në rezultatet e monitorimit, sipas përcaktimeve në pikën 6 të po këtij neni:

6. Ministria, nëpërmjet grupit ndërmintor të punës në fushën e ndryshimeve klimatike, monitoron dhe vlerëson çdo 4 vjet progresin për zbatimin e dokumentit strategjik për ndryshimet klimatike dhe harton raportin, i cili përmban informacionin për:
 - a) vlerësimin e progresit në reduktimin e shkarkimeve dhe përthithjes nga rezervuarët e GES-it, në raport me kontributin kombëtar të përcaktuar (NDC);
 - b) vlerësimin e progresit në zbatimin e Planit Kombëtar të Zbutjes së Gazeve me Efekt Serrë;
 - c) zbatimin e Planit Kombëtar për Përshtatje ndaj Ndryshimeve Klimatike, që përfshin: gjetjet e reja dhe vulnerabilitetit mbi ndryshimet klimatike; aktivitetet e kryera gjatë procesit NAP; progresi dhe vështirësitë në integrimin e përshtatjes në sektorët e tjerë; progresi dhe vështirësitë në arritjen e objektivave dhe indikatorëve; rekomandime për masat në të ardhmen.

Efektet financiare për NJVQV-të do të përcaktohen dhe do të fillojnë pas vlerësimit dhe monitorimit të parë të zbatimit të dokumentit strategjik, siç parashikohet në nenin 5, të projektligjit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij projektligji nuk kërkon shpenzime nga buxheti i shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE
